



Drini Imami është pedagog pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës. Ai mban gradën Doktor i Shkencave në Ekonomi dhe Politika të Bujqësisë dhe Ushqimit nga Universiteti i Bolonjës, Itali dhe që prej vitit 2013 është Profesor i Asociuar (titulli i akorduar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës).

Ai ka kryer kërkime në disa institucione të mirënjohura kërkimore Evropiane si IAMO, BOKU etj., ka marrë pjesë dhe ka referuar në shumë konferenca shkencore ndërkombëtare si dhe ka kontribuar në rreth 60 artikuj në revista shkencore (shumica të indeksuara) përfshirë Cambridge Journal of Regions, Economy and Society,

Post-Communist Economies, Economic Systems, Economics of Transition, Journal of Evolutionary Economics, Communist and Post-Communist Studies, IFAMR etj.

Ai ka marrë disa çmime, grante dhe bursa përfshirë bursën prestigjioze "Brains In" nga Instituti i Studimeve të Avancuara, Qendra e Ekselencës së Universitetit të Bolonjës. Zoti Imami është angazhuar si konsulent nga projekte apo organizata të ndryshme ndërkombëtare në Shqipëri dhe vende të tjera dhe ka kontribuar në shumë raporteve teknike si dhe disa strategji zhvillimi.